

NJOFTIM
Nr. 639/2, datë 22.4.2020

**PËR PUBLIKIMIN E NJË NDRYSHIMI NË FTESËN PËR OFERTË PËR
PROCESIN KONKURRUES, “PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTIT QË DO TË
PËRFITOJË MASAT MBËSHTETËSE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT
FOTOVOLTAIK NË ZONËN E KARAVASTASË”**

Bazuar në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka shpallur ftesën për ofertë për procesin konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit për zhvillimin e “Projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik, në zonën e Karavastasë”.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
“PËR NJË NDRYSHIM NË FTESËN PËR OFERTË”

Në ftesën për ofertë për Procesin Konkurrues, “Për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë masat mbështetëse për ndërtimin e impiantit fotovoltaik në zonën e Karavastasë”, të publikuar në Buletinën e Njoftimeve Zyrtare, të datës 20.1.2020 dhe 27.2.2020, bëhet ndryshimi i afatit për dorëzimin e ofertave dhe hapjes së ofertave, si më poshtë:

Afati për dorëzimin e ofertave: 30 prill 2020, ora 12:00 (ora e Evropës Qendrore).

Nëse oferta dorëzohet me postë, do të konsiderohet se është dorëzuar rregullisht brenda afatit të dorëzimit të ofertave, nëse përmbush kumulativisht:

- data e shënuar në vulën postare të zarfeve, e konfirmuar me anë të njoftimit të shërbimit postar, është jo më vonë se afati i dorëzimit të ofertave (dmth 30 prill 2020, ora 12:00, ora e Evropës Qendrore);

- MIE e merr Ofertën jo më vonë se data e hapjes së ofertave (dmth 8 maj 2020, ora 17:00, ora e Evropës Qendrore).

MIE do të lëshojë konfirmimin e marrjes së ofertës, me datën dhe orën e marrjes. Ofertat e dorëzuesve në dorë pas afatit të dorëzimit të ofertave (i ndryshuar) ose ofertat e dorëzuara me postë që nuk përmbushin kumulativisht kushtet e mësipërme, nuk do të shqyrtohen.

Hapja e ofertave: 17 maj 2020, ora 12:00 (ora e Evropës Qendrore).

Informacion shtesë mbi dokumentet e procesit konkurrues mund të gjeni në *Website*-in e Autoritetit Kontraktues: <http://infrastruktura.gov.al>.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Viola Haxhiademi